VENDIM
Nr. 82, datë 3.1.2020

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BALDUSHK, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve "iii" e "iv", të shkronjës "b", të nenit 13 dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, Njësia Administrative Baldushk, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim.
2. Caktimin e Bashkisë Tiranë për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:
a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
b) ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike;
c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.
3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Pika	Koord_X	Koord_Y
1	401454.19	4561103.29
2	401428.72	4561240.21
3	401451.54	4561241.87
4	401471.72	4561215.08
5	401484.95	4561180.02
6	401478.99	4561178.70
7	401482.96	4561158.52
8	401521.79	4561167.18
9	401528.67	4561133.58
10	401532.23	4561123.93
11	401521.98	4561097.47
12	401503.79	4561088.87
13	401458.81	4561082.92
14	401454.59	4561101.30
15	401454.19	4561103.29



Pika	Koord_X	Koord_Y
1	401454,19	4561103,29
2	401428,72	4561240,21
3	401451,54	4561241,87
4	401471,72	4561215,08
5	401484,95	4561180,02
6	401478,99	4561178,70
7	401482,96	4561158,52
8	401521,79	4561167,18
9	401528,67	4561133,58
10	401532,23	4561123,93
11	401521,98	4561097,47
12	401503,79	4561088,87
13	401458,81	4561082,92
14	401454,59	4561101,30
15	401454,19	4561103,29